

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "PradiumTech" sh.p.k
Rr. "Bardhok Biba, Pall. "Trema Engineering 2, Tiranë
NIPT: L91518008H

VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKËVE

Nr. 02, datë 28/01 /2020

Në Tiranë sot, më datë 29.01.2020, në orën 15:00, u mbledh Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "PradiumTech" sh.p.k, e përbërë nga ortakët si më poshtë:

- Shoqëria "Sestante Holding" SRL, e cila zotëron 65% të kuotave, me përfaqësues ligjor zj. Enida Shehaj;
- Z. Ermal KRISTO, i cili zotëron 5% të kuotave;
- Arjan YMERI, i cili zotëron 20% të kuotave;
- Silvana Bala, e cila zotëron 10% të kuotave;

Mbledhjen e kryesoi përfaqësuesi i ortakut "Sestante Holding" S.r.l., zj. Enida Shehaj, e cila konstatoi se mbledhja është e vlefshme, pasi asambleja është thirrur konform statutit të shoqërisë, sipas njoftimit të datës 03.10.2019, dhe se janë prezent përfaqësuesit 70% të kuotave si më poshtë:

- Shoqëria "Sestante Holding" SRL, e cila zotëron 65% të kuotave, me përfaqësues ligjor zj. Enida Shehaj,
- Z. Ermal KRISTO, i cili zotëron 5% të kuotave;

Përfaqësuesi i ortakut "Sestante Holding" Srl e deklaroi mbledhjen të hapur me këtë **RENDITE**, ku Proces – Verbal i Mbledhjes të mbahet dhe nënshkruhet nga ortaku Ermal Kristo dhe z. Orjon Nallbati, administratori:

1. Shqyrtimin e aktivitetit financiar të shoqërisë dhe mundësinë për prishjen e saj, për shkak të moskryerjes së asnjëllor aktiviteti.
2. Të mbyllë aktivitetin e shoqërisë "Pradiumtech" sh.p.k., duke kaluar shoqërinë në proces likuidimi e sipër.
3. Të caktojë si likuidator z. Alban Berberi.
4. Të ndryshme.

DUKE QENE SE:

Asambleja e Ortakëve të shoqërisë pasi mori në shqyrtim veprimtarinë e shoqërisë, statutin e saj, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, pasi konstatoi kuorumin e saj, diskutoi në lidhje me rendin e ditës, konkretisht si më poshtë vijon:

- Në lidhje me situatën financiare dhe aktivitetin e shoqërisë, u konstatua se kjo shoqëri aktualisht nuk ka asnjë të punësuar dhe nuk po kryen asnjë aktivitet tregtar, sikundër gjithashtu çdolloj e ardhur sigurohet nga ortaku "Sestante Holding" SRL, për këtë arsye Asambleja e Ortakëve me unanimitet të pjesëmarrësve, vendosi që vazhdimi i mëtejshëm i aktivitetit tregtar të kësaj shoqërie, është i pamundur.
- Në lidhje me: "Mbylljen e aktivitetit të shoqërisë "Pradiumtech" sh.p.k., duke kaluar shoqërinë në proces likuidimi e sipër.", Asambleja e Ortakëve me unanimitet të pjesëmarrësve, vendosi miratimin e kësaj pike:

- Në lidhje me caktimin e likuidatorit z. Alban Berberi, të propozuar nga Administratori, Asambleja e Ortakëve me unanimitet të pjesëmarrësve, vendosi miratimin e kësaj pike.

Sa sipër, Asambleja e Ortakëve me unanimitet votash të pjesëmarrësve:

VENDOSI:

1. Të mbyllë aktivitetin e shoqërisë "Pradiumtech" sh.p.k., duke kaluar shoqërinë në proces likuidimi e sipër.
2. Të caktojë si likuidator z. Alban Berberi.
3. Ngarkohet për regjistrimin e këtij vendimi në QKB, administratori z. Orjon Nallbati.

ASAMBLEJA E ORTAKËVE:

SHOQËRIA "SESTANTE HOLDING" SRL

z. Ermal Kristo

përfaqësuar me autorizim nga:

zj. Enida Shehaj

Enida Shehaj
(nënshkrimi)

Ermal Kristo

Vendimi i mësipërm u pranua dhe nga administratori i shoqërisë z. Orjon Nallbati dhe likuidatori Alban Berberi, të pranishëm në këtë mbledhje, të cilët e konfirmuan atë me nënshkrimin e këtij vendimi si vijon:

Orjon Nallbati

Alban Berberi

Orjon Nallbati

Alban Berberi

PradiumTech Shpk, Rruga "Bardhok Biba", Tiranë, Albania, Nipt L9151800811